

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“GRAND DESIGN AND CONSULTING”**

Sot, më datë 04.10.2023 bazuar në Ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, hartohet ky Akt Themelimi i shoqërisë si më poshtë vijon:

Ortaku themelues si më poshtë:

- **Z. Durim Neziri**, lindur më 02.09.1990, në Glllogoc, shtetas Kosovar, mbajtës i pasaportës me numër P02410681.

**NENI 1**

***Emri***

1.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “GRAND DESIGN AND CONSULTING”.

1.2 Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 2**

***Forma***

2.1 Shoqëria tregtare “GRAND DESIGN AND CONSULTING”, ka formën e një Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK).

**NENI 3**

***Zyra Qendrore***

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “GRAND DESIGN AND CONSULTING” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në Shqipëri, Rruga Liman Kaba, Kompleksi Olimpik, Kati i 5, Ap. 117, Njësia Administrative Nr. 5, Zona Kadastrale 8270, Tiranë.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 4**

***Objekti i Veprimtarisë***

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Zhvillimi i projekteve të ndërtimit; Aktivitetet e arkitekturës; Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillimit teknik; Testimi teknik dhe analizat; Kërkimi dhe zhvillimi eksperimental në bioteknologjinë; Kërkime dhe zhvillime të tjera eksperimentale në shkencat natyrore dhe inxhinieri; Kërkimi dhe



zhvillimi eksperimental në shkencat shoqërore dhe humane; Aktivitetet e tjera profesionale, shkencore dhe teknike p.k.t.; Prodhimi i çimentos; Prodhimi i gëlqeres dhe llaçit; Prodhimi i produkteve prej betonit për qëllime ndërtimi; Prodhimi i produkteve prej llaçit për qëllime ndërtimi; Prodhimi i betonit të përzier, i gatshëm për përdorim; Prodhimi i llaçeve; Prodhimi i fibrave të çimentos; Prodhimi i artikujve të tjerë prej betonit, llaçit dhe çimentos; Thyerja e gurit, formësimi dhe dhënia e formës përfundimtare; Prodhimi i produkteve gërryese; Prodhimi i produkteve minerale jometalike p.k.t.; Prodhimi i hekurit dhe çelikut bazë, si dhe i ferrolegurave; Prodhimi i tubave, gypave, profileve bosh dhe pajisjeve të tjera nga çeliku; Riparimi i produkteve metalike të fabrikuara; Riparimi i makinerive; Riparimi i pajisjeve elektronike dhe optike; Riparimi i pajisjeve elektrike; Riparimi i pajisjeve të tjera p.k.t.; Instalimi i makinerive dhe pajisjeve industriale; Prodhimi i energjisë elektrike; Transmetimi i energjisë elektrike; Shpërndarja e energjisë elektrike; Grumbullimin, trajtimin dhe furnizimin me ujë; Kanalizimi; Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore; Ndërtimi i rrugëve dhe autostradave; Ndërtimi i hekurudhave mbi dhe nëntokësore; Ndërtimi i urave dhe tuneleve; Ndërtimi i projekteve të tubacioneve dhe kanalizimeve; Ndërtimi i projekteve të shërbimeve publike për energji elektrike dhe telekomunikime; Ndërtimi i projekteve të ujit; Ndërtimi i projekteve të tjera të ndërtimit civil p.k.t.; Demolimi i objekteve; Përgatitja e vendpunishtes; Testi i shpuarjes dhe shpuarja; Instalime elektrike; Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit; Instalime të tjera ndërtimore; Përfundimi dhe finalizimi i punëve të tjera të ndërtesave; Aktivitetet e tjera të specializuara ndërtimi p.k.t.; Aktivitetet e ndërmjetësimit të specializuar për shitjen e produkteve të veçanta; Tregtia me shumicë e pajisjeve elektronike dhe të telekomunikimit, si dhe pjesëve të tyre; Tregtia me shumicë e veglave të makinerive; Tregtia me shumicë e makinerive të minierave, të ndërtimit, si dhe për punime inxhinierike; Tregtia me shumicë e makinerive dhe pajisjeve; Tregtia me shumicë e produkteve të tjera të ndërmjetme; Kultivimi i kallamsheqerit; Aktivitetet e programimit kompjuterik; Aktivitetet e këshillimeve kompjuterike; Aktivitete të menaxhimit të instalimeve kompjuterike; Aktivitetet e këshillimit për biznes dhe këshillat e tjera për manaxhim.

#### **NENI 5**

##### ***Kohëzgjatja***

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të **pa caktuar**.

#### **NENI 6**

##### ***Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit***

Shoqëria tregtare “GRAND DESIGN AND CONSULTING” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

#### **NENI 7**

##### ***Përgjegjësia e Ortakëve***

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “GRAND DESIGN AND CONSULTING” SHPK.



## NENI 8

### *Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat*

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “GRAND DESIGN AND CONSULTING” SHPK është 100 (njëqind) Lek, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga ortaku.

8.2 Ortaku **Z. Durim Neziri** zotëron 1 (një) kuotë të kapitalit me vlerë 100 (njëqind) lek, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 100 % (njëqind për qind) në kapitalin e shoqërisë.

## NENI 9

### *Organet e Shoqërisë*

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

## NENI 10

### *Administratori*

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është **5 vjet** me të drejtë ripërtëritje. **Administrator** i Shoqërisë është **Z. Sadri Laçi**.

## NENI 11

### *Sekreti tregtar*

Ortakët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “GRAND DESIGN AND CONSULTING” SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

## NENI 12

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës kompetente.

**Ky Akt Themelimi përpilohet në 1 (një) dokument origjinal në gjuhën shqipe dhe firmoset nga ortaku i shoqërisë.**

**ORTAKU THEMELUES**

**Z. DURIM NEZIRI**

